



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 15, datë 23.03.2022

**PËR
RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NGA FONDI I RINDËRTIMIT I
BUXHETIT TË SHTETIT, TË PASHPENZUARA NË VITIN 2021, QË DO TË
TRASHËGOHEN NË VITIN 2022**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.25 datë 9.12.2021 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2021”, të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondeve të përfituara nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit, të pashpenzuara në vitin 2021 dhe që do të trashëgohen në vitin 2022, me të njëjtin destinacion, sipas tabelës së mëposhtëme:

Nr.	VKM që ka miratuar fondin	Emërtimi i produktit	Kodi i produktit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Fondi i mbartur për vitin 2022
1	Nr.644 dt.03.08.2020 Nr.213 dt.31.03.2021	Hartim projekte/plane vendore	94902AI	1	04960	230	34,648,611
2	Nr.540 dt.08.07.2020 Nr.201 dt.25.03.2021 Nr.613 dt.20.10.2021 Nr.715 dt.24.11.2021	Rikonstruksion /riparime te banesave individuale , mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa	94902AB	1	04960	231	111,584,712
3	Nr. 98 dt.17.02.2021 Nr.514 dt.18.09.2021	Rikonstruksion dhe ndertimi i infrastruktures publike	94902AE	1	04960	231	398,403,919
4	Nr.731 dt.16.09.2020	Shembja e objekteve te pabanueshme te demtuara nga termeti	94902AH	1	4960	602	48,728,892
5	Nr.732 dt.16.09.2020	Rikonstruksion /riparime te banesave individuale , mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa	94902AB	1	04960	604	9,036,347
6	Nr. 24 dt. 20.01.2021 Nr.189 dt. 25.03.2021 Nr.333 dt. 02.06.2021	Rikonstruksion /riparime te banesave individuale , mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa	94902AB	1	04960	606	144,638,534
7	Nr.130 dt. 03.03.2021 Nr.205 dt. 25.03.2021	Rindertimi i banesave individuale	94920AC	1	04960	606	40,975,619
Totali fondeve që mbarten në kapitullin 1							788,016,634
8	Nr. 334 dt. 02.06.2021	Rindertimi i banesave individuale	94920AC	6	04960	606	98,972,334
9	Nr. 880 dt.11.11.2020	Rikonstruksion /riparime te banesave individuale , mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa	94902AB	6	04960	604	58,200,000
Totali fondeve që mbarten në kapitullin 6							157,172,334

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 23.03.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 243 / prot.

Durrës, më 25 03 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.15 datë 23.03.2022: “Për rialokimin e fondeve të përfituara nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit, të pashpenzuara në vitin 2021, që do të trashëgohen në vitin 2022.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

